



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:041238
Datë: 28.03.2019
Numri i dokumentit: 00259818

P. nr.1004/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit N. P. , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.1605/17 të dt.08.9.2017, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 12 pika 1.1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit N. P. dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari me dt.027.3.2019 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri N. P. i lindur me dt.... me vendbanim ... Komuna e Vushtrisë,i biri SH. dhe nënës D. e gjinisë S. , i njohur me dokument identifikues numër, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë , pensionist invalidor , i shkurorëzuar , baba i një fëmije ,i gjendjes së mesme ekonomike, kinse i pa dënuar më parë nga gjykata, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 24.2.2017, rreth orës 20:00 , në Pejë , tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet tjetrit dhe atë të dëmtuarit R. M., në atë mënyrë që , gjatë fjalosjes që kishte me të pandehurin i njëjti fillimisht e kishte goditur me kokë në fytyrë , e pastaj e kishte grushtuar në kokë dhe fytyrë , e të cilit i shkakton lëndime të lehta trupore në kokë, dhe rreth syrit të majtë

-me çka ka kryer veprë penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 të KPRK-së..

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 të KPRK-së, I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro , kurse në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 20 euro , dhe në emër të taksës për mbrojtjen e viktimave të krimit shumën prej 30 euro - të gjitha këto 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil .

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.08.9.2017 kundër të pandehurit N. P., ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.1605/17, për vepër penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 pika 1.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, faktin se i pandehuri të dëmtuarin e ka dhëndër dhe tani më janë pajtuar dhe kanë raporte shumë të mira në mes vete , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.27.3.2019.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .